



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Rr. "Illir Konushevc",nr.8 ♦ Prishtinë ♦ Kosovë Tel: ++381 38 500 400 0 Fax: ++ 381 38 248 076

E-mail: [info@pak-ks.org](mailto:info@pak-ks.org) [www.pak-ks.org](http://www.pak-ks.org)

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Listave të Punëtorëve ("KSHALP") i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ("Agjencia", në përputhje me nenin 4, pika 4.2, 4.3 dhe 4.4, të Rregullave të Procedurës të KSHALP, dhe pikës 1.2, të Udhëzuesit për Shpërndarjen e 20% për punëtorët i miratuar në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë me dt. 29.03.2012, pas shqyrtimit të Listave të Përkohshme të ndërmarrjeve shoqërore ("NSH") SHAM "Semafori" në Prizren, dhe "Ekonomia e Pyjeve" në Prishtinë, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.04.2013 merr këtë:

### V E N D I M

- I. Anulohen si të pabazuara Listat e Përkohshme të Punëtorëve për përfitimin e një pjese të të ardhurave prej 20% nga privatizimi-likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore SHAM "Semafori" në Prizren, dhe "Ekonomia e Pyjeve" në Prishtinë, të publikuara me dt. 10.12.2011.
- II. Të gjithë parashtruesit e ankesave dhe punëtorët që janë përfshirë në Listën e përkohshme të NSH-ve të theksuara në pikën 1, të vendimit të njoftohen përmes mjeteve të informacionit publik në Kosovë, Serbi, dhe Mal të Zi, dhe në faqen zyrtare të Agjencisë në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi.

### A r s y e t i m i

Njesia e Listave të Punëtorëve të Departamentit të Likuidimit i Agjencisë, me datë 10.12.2011, në mjetet e shkruara të informacionit publik në Kosovë, Serbi dhe në Mal të Zi ka publikuar Listën e Përkohshme për përfitimin e një pjese të të ardhurave prej 20% nga privatizimi i NSH SHAM "Semafori" në Prizren dhe NSH "Ekonomia e Pyjeve" në Prishtinë, me Njoftimin për të drejtën e ankesës sipas nenit 67.2 të Urdhërësës Administrative, nr. 2008/6, e cila ishte në fuqi, dhe dispozitave të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/13 (me ndryshime).

Listat e përkohshme për këto ndërmarrje shoqërore ishin publikuar vetëm mbi bazën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës punëtorëve, ndërsa nuk kishte asete të shitura dhe Fond në llogari të NSH-ve për shpërndarjen e një pjese të të ardhurave prej 20% për punëtorët, e në kundërshtim me dispozitat e nenit 10, pika 10.5 dhe 10.6 (c). të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2003/13 (me ndryshime)

**Meqë, ndërmarrja shoqërore SHAM "Semafori" në Prizren dhe "Ekonomia e Pyjeve" në Prishtinë nuk kanë asete të shitura, e në mungesë të Fondit në llogarinë e NSH-ve të theksuara më lartë për shpërndarjen e një pjese të të ardhurave prej 20% për punëtorë, KSHALP vendosi si në dispozitiv të Vendimit.**

